

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Raca e re gjigante e deleve që po bën bujë! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/raca-e-re-gjigante-e-deleve-qe-po-ben-buje/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:41:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:31:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d2ab1c536f1982b02e1debe544a80541651507e768af995daf32e253bd8cde8c
TEKSTI	2c5a596d12d18954d2bb892faaf948a28924651c64a577db754e7d83c3d4b152
PAMJA	d9fdeddac351f43ca317fe0257d645bea1a16f2f33c9627129e1c7aa886fbff3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	551849b74e7de7db5d53887528b5ff0b6e9f78dc6ab625dedc365667a49ed9d8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/551849b74e7de7db5d53887528b5ff0b6e9f78dc6ab625dedc365667a49ed9d8

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Botë e Çuditshme

Raca e re gjigante e deleve që po bën bujë!



Marisa Karabeci
28 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Një racë e re delesh në Kirgizi po shkakton një valë thashethemesh në gjithë Azinë Qendrore, ku deshtë po shiten për shuma tejet të larta. Raca Arashan u regjistrua zyrtarisht në Kirgizi në prill të vitit 2021. Që atëherë, çmimet kanë shënuar rritje të madhe, ndërsa fotografite e deshëve gjigantë të kësaj race kanë bërë xhiro në rrjetet sociale. Në vitin 2023, një dash riprodhues i racës Arashan u shit për 150.000 dollarë, ndërsa, sipas raportimeve, çmimet janë rritur edhe më shumë. Në një panair delesh në prill, një dash i ri u vlerësua me 500.000 dollarë, ndërsa pas një aktiviteti të mbajtur më 19 shtator pranë Bishkekut, u raportua se një qengji i racës Arashan, i rritur në Kirgizi, ishte shitur së fundmi te një mbarështues në Kazakistan për 1 milion dollarë.

“Qengji që u shit për 1 milion dollarë quhet Antibiotik”, tha për REL-in bujku kirgiz i deleve, Ulan Atabaev, i cili pretendoi se i njihte mbarështuesit e përfshirë në marrëveshjen e raportuar. Blerësi i qengjit të çmuar, me bazë në Kazakistan, ua përcolli pyetjet e REL-it një avokati, i cili tha vetëm se “Antibiotiku iu shit mbarështuesit Kuanysh Mykytbayev për një shumë të konsiderueshme”. Mirlan Satybekov, kryetar i Shoqatës Publike të Mbarështuesve të Deleve në Kirgizi, i tha REL-it se vlera e racës Arashan lidhet me përmasat e saj, rritjen e shpejtë dhe qëndrueshmërinë e nevojshme për klimën dhe terrenin e ashpër të Kirgizisë. “Përveç kësaj, janë thjesht dele shumë të bukura”, tha Satybekov.

Arashanët me linja të vlefshme gjaku kanë hundë të theksuara, të njohura si “hundë romake”, veshë të gjatë dhe bishta të varur e të mbushur me dhjamë. Delet rriten për mish, ndërsa qengji dhe mishi i deles janë pjesë përbërëse e ushqimit në Azinë Qendrore. Satybekov i tha REL-it se ekzemplarët gjigantë të deshëve riprodhues Arashan përdoren si “përmirësues” për të rritur përmasat dhe, rrjedhimisht, vlerën e tregut të brezit të ardhshëm të tufave të deleve. Bujqit paguajnë shuma të konsiderueshme për pronarët e deshëve të famshëm Arashan për të mbarësuar delet e tyre.

Përveç kësaj, meshkujt e rinj nga një baba i famshëm mund t'u shiten mbarështuesve të tjerë për cmime sa një shtëpi. Në fillim të këtij viti, mbarështuesi kazak Mvktvbayev publikoi një video të

dy deshëve Arashan që iu shitën një mbarështuesi uzbek për një shumë të pretenduar prej gjithsej 275.000 dollarësh. Disa komentues kirgizë e kanë krahasuar valën e spekulimeve rreth Arashanëve me skemat Ponzi, ndërsa në internet ka shpërthyer debat lidhur me raportimet se njerëzit po marrin kredi të rrezikshme ose po shesin makina apo shtëpi për të blerë deshë riprodhues.

Ndryshe nga pasuritë që paguhen për kafshët elitare të shumimit, çmimi i një Arashani të rritur përcaktohet nga çmimi i mishit të deles në treg. Pasi theret, një Arashan i rritur jep mish me vlerë prej disa qindra dollarësh, nga rreth 50–60 kilogramë mish, bazuar në çmimet e tregut. Delet Arashan dolën nga një eksperiment mbarështimi i zhvilluar në qytetin kirgiz Kant në vitet '70. "Gjatë periudhës sovjetike, në Kant kishte një stacion për testimin e makinerive bujqësore dhe drejtori i tij në atë kohë ishte një burrë me emrin Zubkov", i tha Satybekov REL-it.

"Ai solli deshë riprodhues të racës Hissar nga Tashikistani dhe filloi t'i kryqëzonte me delet tona vendase, të rritura për mish dhe dhjamë". Aktualisht, në Kirgizi janë rreth 48.000 Arashanë, një pjesë e vogël e rreth 5.6 milionë deleve që përbëjnë të gjithë popullatën e deleve në vend. Rekordi i peshës për një Arashan u vendos në qershor të vitit 2026, me 236 kilogramë, vetëm pak më pak se një dash i racës Suffolk në Shtetet e Bashkuara, i cili në vitin 1991 peshonte 247,2 kilogramë dhe u bë delja shtëpiake më e rëndë e regjistruar ndonjëherë.

Në mes të një ndalimi për eksportin e deleve, i cili synonte të frenonte rritjen e çmimeve të mishit në Kirgizi, këtë verë u bë një përjashtim për Arashanët. "Gjatë dy muajve të fundit kemi eksportuar 215 dele Arashan në Uzbekistan", tha Satybekov, pasi ndalimi u hoq për Arashanët. "Ka gjithashtu interes nga Rusia. Neve kanë ardhur të na vizitojnë edhe bujq nga Moldavia dhe Gjeorgjia. Ata po shohin se si mund t'i marrin kafshët me vete, por për momentin po përcaktojmë se si mund të bëhet e gjithë kjo".

LAJME TË NGJASHME



20 deve skualifikohen nga konkursi i bukurisë, shkak botoksi dhe silikoni!

1 MIN



E rrallë/Një dele në Turqi lindi 9 qengja në një pjellë të vetme!

1 MIN



Delet "pushtojnë" një rrugë të Kalifornisë!

1 MIN



Vendi që ka më shumë dele se njerëz!

1 MIN



Dënohet me burg amerikani, klonoi delen gjigante!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin



"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..." / Dua Lipa ndan



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e



Nations League, sonte SHQIPERI vs.



Aksident në Fushë-Krujë/Përplasen 3 automjete,

seksual!

pamje nga dasma familjare!

zodiakut!

BJELLORUSI/Ekskluzivisht në
DigitAlb!

humb jetën një 19-vjeçar!



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!



A kaloni shumë kohë ulur? Ja çfarë mund të ndodhë nëse ecni çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtrën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?

EDITORI SUGJERON



Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja se kur tradhtojnë çiftet në një lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...



Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...



Keni rënë në dashuri?! Apo është thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me "iPhone Duo"... por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërtoni telefonin sipas Mateo Kadriut...



Do të habiteni kur të zbuloni fuqinë e kanellës!



A mund të konsumoni kafe gjatë ushqyerjes në gjë?! Ja se çfarë thotë studimi...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktoni
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.